



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 423/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Gyltene Sylejmani, kryesuese, Faton Ademi dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS), me seli në Graçanicë, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datë 07.11.2019, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 09.11.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** i pabazuar apeli i parashtruar nga subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS), me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave në Vendvotimin 2810B/01D.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 07.11.2019 në ora 13:00, nga subjekti politik SLS-së, duke pretenduar se ka pasur parregullsi me rastin e plotësimit të Formularit për Përputhjen e të Dhënave dhe Rezultateve, në VV2810B/01D, ku janë regjistruar të dhënat për 24 subjekte politike nga gjithsejtë 25 subjekte politike. Parashtruesi i apelit ka kërkuar nga PZAP-i që të rinumërohen fletëvotimet në VV 2810B/01D si dhe të bëhet verifikimi i validitetit të këtyre fletëvotimeve.

PZAP-i, pas vlerësimit të pretendimeve në apel, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pabazuar**

PZAP-i, konstatoi se apeluasi në apelin e paraqitur kërkon që të rinumërohen fletëvotimet e VV2810B/01D, sepse në Formularin për Përputhjen e të Dhënave dhe Rezultateve, janë regjistruar të dhënat për 24 subjekte politike nga gjithsejtë 25 subjekte politike, të cilat kishin garuar për zgjedhjet e 06 Tetorit 2019.

Paneli vlerëson se apeli i apeluasit për rinumërim të fletëvotimeve në VV2810B/01D, është i pa bazuar për arsye se KQZ-ja, ka bërë rinumërimin e votave për të njëjtin vendvotim dhe se rezultati i dalur nga ky rinumërim, është përfshirë në rezultatet e publikuara nga KQZ-ja,

më datë 07.11.2019, andaj paneli, për këtë arsye vlerëson se përsëritja edhe njëherë e rinumërimit në vendvotimin e njëjtë konsideron të panevojshëm në këtë rast.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**  
Anr.423/2019 më datën 09.11.2019

**Kryesuese e Panelit**  
Gyltene Sylejmani



***Udhëzim Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si **përfundimtare**. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*